

SPECIFIKIMET TEKNIKE

MUFTE PER KABLLOT NJE FAZORE TE TM 20 KV ME IZOLIM LETER, IMPRENUAR NE VAJ

MUFTE PER KABLLOT NJE FAZORE TE TM 20 KV, ME IZOLIM LETER, IMPRENJUAR NE VAJ

1.1 Te pergjitheshme

Te gjitha muftet nje dhe trefaze 20 kV jane projektuar qe te jene te sigurt ne kushte klimatike te ndryshme pa pesuar demtime, duke ruajtur strukturen, ndertimin elektrik dhe mekanik te vete kabllit. Muftet nje dhe trefazore 20 kV duhet te jene te sigurta edhe kur jane ne ngarkese , nen tension apo nen veprimin e lidhjes se shkurter apo avarive te tjera qe mund te ndodhin ne sistem, ato duhet te sigurojne dhe punojne ne kushte optimale

Ilustrim

(Ilustrimet dhe dimensioned jane orientuese)



1.2 Kerkesa te detyrueshme

Eshte e detyrueshme qe furnizuesi te siguroje:

- Certifikatat e prodhuesit ISO 9001
- Te dhenat teknike sic kerkohen ne specifikime teknike
- Te gjitha test raportet e fabrikes
- Skicat me dimensione
- Manual perdorimi
- Te kene marketim CE

1.3 Kushtet e sistemit

Te dhena per sistemin

Specifikime	Njesia	Sistemi 20 kV
Tensioni nominal në sistem	kV	20
Tensioni më i lartë për paisjet	kV	24
Frekuenca e sistemit	Hz	50
Numri i fazëve		3
Sistemi i tokezimit		e izoluar

Kushtet atmosferike

Temperatura maks. e ambientit	40 °C
Temperatura maks. mesatare ditore	30 °C
Temperatura minimale e ambientit	-10 °C
Temperatura maks. në sipërfaqet e ekspozuara në diell	60 °C
Lageshtia relative maks (në tokë)	95 %
Lageshtia relative maks (në ajër)	80 %
Lartësia maksimale mbi nivelin e detit	<1000 m

Testet fizike dhe elektrike duhet të jenë në përputhje me standartet IEC ose ekuivalentet e tyre. Materialet duhet të jenë sipas standartit ISO 9001 ose një standart më i avancuar.

1.4 Përshkrim, kërkesa dhe të dhëna



Muftet duhet të jenë të kompletuara me të gjitha pjesët përberëse të nevojshme për të ruajtur dhe siguruar strukturën normale të vetë kabllëve ku përdoren. Ato duhet të respektojnë plotësisht kërkesat elektrike dhe mekanike të të dy tipeve të kabllëve.

Muftet duhet të jenë me material termotkurrës.

Ekrani me rrjetë bakri, i cili aplikohet mbi trupin e xhuntos, duhet të jetë i dimensionuar në mënyrë të mjaftueshme që të lejojë të kalojnë nepermjet muftës rrymat e plota të lidhjes me token të sistemit.

Lidhja elektrike e ekranit metalik të kabllit bëhet me lidhës (gilzë) në rastin e ekranit me përcjellës bakri, ndërsa në rastin e ekranit me shirit bakri me thurrje bakri, me susta dredhese. Të dyja duhet të jenë në kompletin e muftës.

Izolimi me leter i dejeve vishet me tubin për bllokimin e vajit

Dejet duhet të bashkohen me anën e gilzës me bullon që gjendet brenda setit.

Gilzat duhet të jenë në përputhje me standartin ndërkombëtar IEC-1238-1. Ato fashohen me shiritin e kontrollit të stresit.

Në funde vendoset mastika e verdhe (shiriti i ngushtë) për bllokimin e vajit. Pjesa ndërmjet dejeve dhe mbulesës metalike të përbashkët nastrohët me mastikën e verdhe (shiriti i gjërë)

Në komplet duhet të përfshihet edhe lidhja me token pa saldim.

Në komplet është edhe rjeta metalike mbrojtëse

Hermetizimi dhe qëndrueshmëria mekanike e jashtme e muftës realizohet me një tub të termotkurrshëm me parete të trasha dhe i veshur me ngjites të termoshkrishëm, i cili gjatë nxehjes shkrin shkrin dhe ngjitet me

siperfaqen e jashtme te kablit. Ky tub duhet te kete qendrueshmeri te mjaftueshme per t’I qendruar veprimit te peshave te mprehta dhe duhet te jete rezistent perkundrejt ujit dhe rrezeve ultraviolet.

Seti i mufteve te furnizuara duhet te permbaje te gjitha materialet dhe komponentet e nevojshme per montimin e tyre ne te gjitha kabllin(ne te tre dejet) .

Muftet duhet te jene dimensionuar ne menyre te tille qe te lejojne kushte te pershtatshme instalimi.

Seksioni per te cilin perdoren percaktohet ne kerkesa.

1.5 Aplikimi

Muftet duhet te perdoren per kabell me percjelles alumini ose bakri me izolim me leter te imprenjuar ne vaj me nje ose trefaze, deri 35 kV.

Muftet jane te ndertuara per kablo nentokesore, ne kanalinat e kabllave ose ne ajer.

1.6 Standartet referuese

Muftet 10, 20, 35 kV nje dhe tre fazore duhet te jene konform kerkesave te standarteve CENELEC HD 629.1 S1, ose ekuivalentet e tyre.

1.7 Testet

Testet duhet te kryhen conform standartit CENELEC Standard HD 629.1 S1

Muftet jane testuar dhe aprovuar ne perputhje me standartet nderkombetare.

1.8 Identifikimi dhe paketimi

Paketimi duhet te jete I projektuar ne menyre te tille qe te mbroje mallin nga hyrja e ujit dhe demtimet mekanike. Te gjitha pjeset perberese duhet te ruajne parametrat teknike ne temperaturat -5°C deri 40 °C. Cdo muftet duhet te kete brenda ambalazhimit udhezimet e instalimit, aplikimin, diapazonin e perdorimit si dhe emertimin dhe sasine e pjeseve perberese. Emertimet, diapazoni, emri firmes prodhuese duhet te jete i stamposur mbi cdo pjese perberese.

Tabela e te dhenave

NR	PERSHKRIMI	NJESIA	kerkesa	Funk.e garantuara
I	MUFTET ME TERMOTKURJE TE TM			
1	TE DHENA TE PERGJITHESHME			
1.1	Standarti i aplikuar			
1.2	Prodhusi			
1.3	Tipi i muftes			
1.4	Tesioni i rrjetit	kV	Sipas kerkeses	

1.5	Numri i dejeve	cop	Sipas kerkeses	
1.6	Seksioni per te cilin perdoret	mm ²	Sipas kerkeses	
1.7	Diametri i seksionit	mm		
1.8	Gjatesia e muftes	mm		
1.9	Tipi i gilzes			
1.10	Material ii gilzes		Sipas kerkeses	
1.11	Seksioni per te cilin perdoret	mm ²		
1.12	Gjatesia e gilzes	mm		
1.13	Diametri i jashtem i gilzes	mm		